

KIS Interpretimi 25

Tatimet mbi të Ardhurat—Ndryshimet në Statusin Tatimor të një Njësie Ekonomike ose Aksionarëve të saj

Referencat

- IAS1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* (ndryshuar në 2007)
- SNK 8 *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*
- SNK 12 *Tatimet mbi të ardhurat*

Çështja

- 1 Një ndryshim në statusin tatimor të një njësie ekonomike ose të aksionarëve të saj mund të ketë pasoja për njësinë ekonomike duke rritur ose ulur detyrimet ose aktivet e saj tatimore. Kjo për shembull mund të ndodhë me listimin publik në bursë të instrumenteve të kapitalit të vet të njësisë ekonomike ose me ristrukturimin e kapitalit të vet të njësisë ekonomike. Kjo gjithashtu mund të ndodhë me zhvendosjen e një aksionari kontrollues në një shtet tjetër. Si rezultat i ngjarjeve të tilla, njësia ekonomike mund të tatohet ndryshe; ajo mundet për shembull të përfitojë ose humbasë lehtësi tatimore ose të bëhet subjekt i një përqindje tatimore të ndryshme në të ardhmen.
- 2 Një ndryshim në statusin tatimor të një njësie ekonomike ose të aksionarëve të saj mund të ketë një efekt të menjëhershëm ndaj detyrimeve ose aktiveve tatimore aktuale të njësisë ekonomike. Ndryshimi gjithashtu mund të rrisë ose të ulë detyrimet dhe aktivet tatimore të shtyra të njohura nga njësia ekonomike, në varësi të efektit që ka ndryshimi i statusit tatimor në pasojat tatimore që krijohen nga rikuperimi ose shlyerja e vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të njësisë ekonomike.
- 3 Çështja është se si njësia ekonomike duhet të kontabilizojë pasojat tatimore të një ndryshimi në statusin e saj tatimor ose në atë të aksionarëve të saj.

Konsensusi

- 4 Ndryshimi në statusin tatimor të njësisë ekonomike ose të aksionarëve të saj nuk krijon rritje ose ulje në shumat e njohura drejtpërdrejt në kapitalin e vet. Pasojat tatimore aktuale dhe të shtyra të ndryshimit në statusin tatimor duhet të përfshihen në fitimin ose humbjen e periudhës, përveçse kur këto pasoja lidhen me transaksione dhe ngjarje që rezultojnë, në të njëjtën periudhë ose në një periudhë tjetër, me një kreditim ose debitim të drejtpërdrejtë të një shume të njohur në kapitalet e veta ose të shume të njohur në të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse. Ato pasoja tatimore që lidhen me ndryshimet në shumën e njohur në kapitalet e veta, në të njëjtën ose periudha të ndryshme (të pa përfshira në fitimin ose humbjen), duhet të kalohen ose kreditohen drejtpërdrejt në kapitalin e vet. Ato pasoja tatimore që lidhen me shumën e njohur në të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse duhet të njihen në të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse.

Data e Konsensusit

gusht 1999

Data e hyrjes në fuqi

Ky konsensus hyri në fuqi në 15 korrik 2000. Ndryshimet në politikat kontabël duhet të bëhen në përputhje me SNK 8.

SNK 1 (i rishikuar në 2007) ndryshoi terminologjinë e përdorur në të gjithë SNRF-të. Në përputhje me këtë u ndryshua paragrafi 4. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore nga 1 janar 2009 e në

vazhdim. Nëse një njësi ekonomike zbaton SNK 1 (i rishikuar në 2007) për një periudhë më të hershme, ndryshimet do të zbatohen për këtë periudhë më të hershme.